



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.100/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada- Gllgjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Therandë për shkak të vendosjes së posterit në shtyllë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Therandë i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 4,300.00 (*katërmijë e treqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 06.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017 në rrugën tranzit “Brigada 123” në Therandë, aktivisti i tyre ka vërejtur se nëpër shtylla elektrike ishte vendosur poster i një kandidate për deputete nga radhët e Koalicioni PDK-AAK-NISMA.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicioni PDK-AAK-NISMA, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.06.2017, Koalicioni PDK-AAK-NISMA konsideron se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivistë të painformuar mirë me rregullat zgjedhore, respektivisht me Rregullën nr.11/2013, neni 4.1, (b). Përkundër kësaj koalicioni ka ndërmarr masat e duhura për të përmirësuar shkeljen e pretenduar. Lidhur me veprimet e ndërmarra përgjigjes në ankesë iu ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatës për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA është vendosur në shtyllë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterët e kandidatëve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA janë vendosur në objekt publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e tyre është e përsëritur disa herë gjatë këtij procesi zgjedhor, dhe faktin se posterit i kandidatës për deputete nga ky koalicion është vendosur në shtyllë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se koalicioni në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se, brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.100/2017 më datën 07.06.2017



**Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.